




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.04.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 180, të datës 20.03.2015, paraqitur nga Drejtoria për Financa dhe Buxhet, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2014, në shumë të përgjithshme prej 7,876,173.77€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër njësitë buxhetore ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Në Administratë buxheti i shpenzuar është 3,375,325.09€
 - 2.2 Në Arsim buxheti i shpenzuar është 3,046,866.61€
 - 2.3 Në Shëndetësi buxheti i shpenzuar është 1,424,809.72€ dhe
 - 2.4 Në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim buxheti i shpenzuar është 29,172.35€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa dhe Buxhet.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë për FB dhe Arkivës.**



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.04.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 253, të datës 16.03.2015, paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria për Planifikim Urban, në lidhje me kërkesën Nr. 39, të datës 22.01.2015 e paraqitur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi Nr. 253, i datës 16.03.2015 për ndarjen e 200m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1000m² në Ngastrës Kadastrale Nr. P-72514036-00767-12 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, pronë e P.SH Kuvendi Komunal Fushë-Kosovë, e evidentuar në certifikatën e pronës me numër 25-3133, për ndërtimin e objektit përdhësë P+0 në sipërfaqe të ndërtimit prej 100m², për institucionin publik Zyra e Punësimit, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. Sipërfaqja e lejuar prej 200m² për Zyra e Punësimit në komunën e Fushë-Kosovës, mbetet në pronësi të komunës së Fushë-Kosovës.
3. Objekti ndërtimor në sipërfaqe prej 100m², për Zyra e Punësimit në komunën e Fushë-Kosovës, financohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorisë për PU, Drejtorisë për GJKP, Drejtorisë për INSPK dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi